

AASF mbështetet nga BERZH dhe Qeveria e Shqipërisë



STUDIM MBI EFEKTIN E COVID-19 NË AGROBIZNES

Maj 2020

STUDIM MBI EFEKTIN E COVID-19 NE AGROBIZNES

Maj 2020

AASF Project Office
Rr. Andon Zako Çajupi, No. 7
Tiranë, Albania
Tel: +355 69 294 1513
www.aasf.com.al
Info@aasf.com.al

“Përhapja e Covid-19 është para së gjithash një tragjedi njerëzore, duke prekur qindra mijëra njerëz. Ajo gjithashtu ka një ndikim në ekonominë globale.

Nuk është e mjaftueshme të njohësh ndikimin e pandemisë Covid-19 në ekonomi, veçanërisht në sektorin bujqësor, dhe domosdoshmeria për të hartuar një plan masash të detajuar për siguruar një mjedis të favorshëm brenda të cilit sektoret ekonomik të mund të parandalojnë sadopak pasojat katastrofike.”

Studimi është një vlerësim i shpejtë, duke marrë në konsideratë burimet dhe kohën e kufizuar në dispozicion, ai trajton në veçanti nevojën për financim në zinxhirin e vlerës të nën-sektorëve që afektohen nga pandemia Covid-19 dhe marrja e një plani masash për ecurinë e sektorëve të tjerë që për momentin nuk janë të prekur. Vlerësimet në këtë studim janë kryer nga autori bazuar në të dhënat statistikore të UNSTAT dhe FAOSTAT, ndërsa të dhënat statistikore të muajve në shqyrtim janë bazuar në informacionet e marra nga aktorët e zinxhirit të vlerës.

Studimi është projektuar në mënyrë të tillë që të jetë i lehtë për t'u lexuar, për sa i përket strukturës, rrjedhës logjike dhe nivelit të hollësive të informacionit, duke iu përshtatur nevojave të vendimmarrësve.

Ilir PILKU

Autor i studimit

PËRMBAJTJA

1. TË PËRGJITHSHME.....	7
2. QËLLIMI I STUDIMIT.....	8
3. PANDEMIA NË SHQIPËRI	9
4. NDIKIMI I PANDEMISË NË EKONOMINË SHQIPTARE	10
4.1. Ndikimi ekonomik.	10
4.2. Investimet, kursimet dhe konsumi privat.	10
4.3. Produktiviteti dhe Burimet Njerëzore.	11
4.4. Sektorët e bujqësisë që paraqiten në fazë prodhimi	
për treg gjatë kësaj periudhe pandemie Covid-19	11
4.4.1 <i>Prodhimet e perimeve në serra.</i>	<i>12</i>
5. NDIKIMI I COVID-19 NË PRODUKTET PRANVERORE	
DHE AKSESI NË TREGJE.....	19
6. KONKLUZIONE.....	28
Financimi Bankar	28
Agrobiznesi.....	29

1. TË PËRGJITHSHME

OBSH e shpalli COVID-19 një pandemi botërore në 11 Mars 2020. Në mesazhin e saj, ajo informoi popullatën botërore se koronavirusi (SARS-CoV-2) do të përhapet në mënyrë të pashmangshme në të gjitha pjesët e botës, e cila nën menaxhimin e qeverive respektive, bizneseve dhe individëve, do të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në ndryshimin e trajektores së sëmundjes.

Përhapja e COVID-19 u shkaktua në fillim të Dhjetorit 2019 në qytetin Wuhan në provincën Hubei të Kinës. Fillimisht epiqendra e shpërthimit ishte Kina dhe sipas raporteve, shpërndarja e saj ka ndodhur nëpërmjet turistëve që nëpërmjet udhëtimeve ndërkombëtare, ndërkohë që tashmë COVID19 vazhdon të përhapet në të gjithë botën. Në mes të ngadalësimit të ekonomise boterore me ndërprerje të prodhimit, funksionimi i zinxhirëve global të furnizimit ka krijuar një mungesë kordinimi. Kompanitë në të gjithë botën, pavarësisht nga madhësia, varen nga inputet nga Kina dhe kanë filluar të përjetojnë perballje me kontraktimet në prodhim.

2. QËLLIMI I STUDIMIT

Qëllimi i përgjithshëm i këtij studimi është që të japë një panoramë të përgjithshme të produkteve bujqësore të sezonit në Shqipëri, kryesisht të perimeve në serra dhe luleshtrydhes, duke analizuar zhvillimet e fundit dhe gjendjen aktuale, me fokus të veçantë ndikimin e situatës pandemike Covid-19 në gjithë zinxhirin e vlerës duke përfshirë edhe Institucionet Financiare, dhe mundësitë për të mitiguar riskun e humbjeve në këto sektorë. Për të realizuar qëllimin e këtij studimi janë përdorur burimet dytësore dhe parësore të informacionit/të dhënave, kryesisht referuar statistikave të FAO-s, UNSTAT dhe INSTAT. Të dhënat operuese për aktivitetet e shqyrtuara i janë referuar Kartave Teknologjike në bujqësi, ndërsa përditësimi i të dhënave mbi cmimet e shitjes në nivel ferme apo atyre të eksportit janë siguruar nga kontaktet e zhvilluara për një periudhë 2 mujore me fermerët potenciale dhe 4-5 eksportuesit e medhenj në Shqipëri. Pra theksojmë që në analizën e përshkruar për pamundësi aksesit dhe procesimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, janë siguruar të dhënat statistikore të volumeve të shitjes bazuar në kalendarin periodik të viteve të kaluara dhe informacionet e siguruar nga tregjet dhe eksportuesit.

3. PANDEMIA NË SHQIPËRI

Shqipëria u fut zyrtarisht në hartën e vendeve të prekura nga pandemia COVID-19 më 9 mars dhe prej asaj dite janë shënuar 946 raste pozitive dhe 31 raste me humbje jete. Qeveria Shqiptare ka urdhëruar një regjim të rreptë të ndalimit të lëvizjeve si një mënyrë për të ndaluar zinxhirin e transmetimit të virusit në popullatë. Mbrëmjen e datës 24 Mars 2020, qeveria shpalli gjendjen e fatkeqësisë natyrore në vend, si një përshkallëzim i ri për situatën e krijuar nga pandemia COVID-19. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka marrë një sërë masash për të parandaluar përhapjen e COVID-19. Vendimi i qeverisë lidhet me pezullimin e mësimin në institucionet arsimore, masat për shmangien e grumbullimeve të njerëzve, rekomandimet për të punuar nga shtëpia, ndërprerja e një sërë aktiviteteve tregtare, masat e shtuara të kujdesit që duhet të aplikohen masivisht, etj.

Gjithashtu me datë 12 mars 2020, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi shtimin e një dispozite të përkohshme në rregulloret e administrimit të rrezikut të kredisë për bankat dhe të administrimit të rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka dhe të shoqërive të kursim-kreditit, e cila synon t'u krijojë lehtësi këtyre subjekteve, që në rastet e paaftësisë paguese e kredimarrësve gjatë periudhës tremujore, këto institucione të mos jenë subjekt i zbatimit të kërkesave të këtyre rregulloreve që lidhen me klasifikimin dhe krijimin e fondeve për provigjione. Në këtë mënyrë, do të jetë e mundur që bankat dhe institucionet e tjera financiare të sipërpërmendura të akomodojnë nevojat e klientëve për një riskedulim të kësteve të kredisë, duke mos i ngarkuar ata me penalitete apo me përkeqësim të statusit të kredimarrësit, duke qenë se mospagimi i kredisë ka ardhur si pasojë e kushteve të vështira të këtyre ditëve jashtë kontrollit të tyre. Masat për riskedulimin e kësteve të kredisë hyri në fuqi në datën 13 mars 2020 dhe do zgjasë deri në datën 31 Maj 2020. Banka e Shqipërisë parashikon që gjatë kësaj periudhe, ata kredimarrës individë dhe biznese, gjendja financiare e të cilëve përkeqësohet nga situata aktuale, mund të përfitojnë një shtyrje, deri në 3-muaj, të pagesave të kësteve të kredive të tyre, të marra nga institucionet financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë: banka, jobanka dhe shoqëri kursim-kreditit. Ky vendim theksohet që ky proces bën të mundur vetëm riskedulimin e detyrimeve që këta kredimarrës kanë, por jo falje të tyre. Në zbatim të këtij vendimi, Institucionet Financiare (banka, jobanka, shoqëria e kursim-kreditit) në bashkëpunim me kredimarrësin, do të vlerësojnë kërkesën dhe, bazuar në specifikat e rastit, do të ofrojë edhe zgjidhjen përkatëse. Ndërkohë, kredimarrësit, aftësia paguese e të cilëve nuk preket apo dëmtohet nga kjo situatë duhet të vijojnë normalisht shlyerjen e detyrimeve të tyre me këto institucione.

4. NDIKIMI I PANDEMISË NË EKONOMINË SHQIPTARE

4.1. NDIKIMI EKONOMIK.

Përtej humbjeve të jetës dhe ndikimeve në shëndetin e të infektuarve, Covid-19 tashmë ka një ndikim të madh në ekonominë e vendit, nisur nga ulja e prodhimit dhe sektorëve ekonomik që do sjellë një deficit të lartë në buxhet dhe të ardhura më të ulëta në ekonomitë shtëpiake. Pritet që Prodhimi i Pergjithshëm Bruto (PBB) dhe investimit do të kenë ulje të ndjeshme. Karantinat në shkallë të gjerë, kufizimet e udhëtimit dhe masat për distancimin shoqëror kanë shkaktuar një rënie të ndjeshme të shpenzimeve të konsumatorit dhe biznesit, gjë që pritet të vazhdojë deri në fund të tremujorit të dytë, duke prodhuar një recesion. Megjithatë qeveria po mundohet të mbajë situatën ekonomike nën kontroll, vetë dinamika vetë-përforcuese e një goditje recesioni do të ketë një ndikim deri në fund të 3-mujorit të tretë. Gjatë fashës së parë të situatës pandemike ekonomia bujqësore dhe kryesisht aksesi në tregje (të brendshme dhe eksporti) dhe financime bankare është ndeshur me një problematikë të lartë, që kryesisht ishte si pasojë e paqartësisë operuese dhe rregullave kombëtare dhe ndërkombëtare të vendosura bazuar kjo në masat e këshilluara nga WHO për Covid-19. Në situata të tilla mundësitë e falimentimeve të SME-ve në bujqësi janë të larta, duke sjellë një presion të ndjeshëm në sistemin bankar dhe financiar.

Ndërkohë që kemi një reflektim pozitiv në periudhën e dytë të pandemisë, që starton me fillimin e muajit Prill, ku aksesi në tregjet lokale dhe atyre të eksportit u rrit ndjeshëm, gjë që në disa aktivitete rekuperoi edhe humbjet gjatë fashës së parë (20 Mars - 31 Mars, 2020). Vlen të theksohet që situata pandemike në ekonominë bujqësore për periudhën e analizuar (20 Mars - 10 Maj 2020) ka qenë shumë pak e ndjeshme, dhe ndërkohë duhet të monitorohet periudha e mbetur që lidhet me perfundimin e tregtimit të produkteve stinore të analizuara, pa anashkaluar periudhën post-pandemike e cila merr një rëndësi të vecantë.

4.2. INVESTIMET, KURSIMET DHE KONSUMI PRIVAT.

Perballë uljes së të ardhurave publike dhe rritjes së shpenzimeve, kriza mund të devijojë shpenzimet publike nga investimet e planifikuara në sektoret e rëndësishëm ekonomik, duke u fokusuar në rritje kapitali për shëndetin dhe shpenzime të tjera sociale. Investimet private të huaja dhe vendase do jenë gjithashtu pjesë e kësaj rënie në afat të shkurtër dhe ndoshta edhe të mesëm. Kriza dhe rënia ekonomike po ndikojnë në investimet dhe flukset e kapitalit. Nëse situatën e gjykojmë në drejtim të zgjerimit dhe zhvillimit të biznesit, gjë që kërkon përdorimin më shumë të inputeve, e shoqëruar me mekanizim apo teknologji të lartë përpunuese, vendet nga të cilat do t'i marrim këto janë të mbyllura, që do të thotë se do të perballemi me një pengesë në aftësinë dhe planifikimin tonë për t'u zgjeruar. Afektimi i kësaj pandemie mund të shtyjë ose pezullojë investimet në projekte të mëdha të financuara nga grandet, projekte këto parashikojnë një injektim kapitali në sektorët publik si dhe në ekonomitë private sic është programi IPARD apo fondet e IPA-s.

4.3. PRODUKTIVITETI DHE BURIMET NJERËZORE.

Situata pandemike ka zvogëluar aksesin në fuqi punëtore duke ulur potencialisht sasinë dhe cilësinë e mallrat dhe shërbimeve, veçanërisht shërbimet publike. Humbjet e jetës dhe paniku mbi mundësinë e të infektuarit me Covid-19, duke shtuar edhe masat e kufizimeve të vendosura nga shteti, ka shkaktuar një ulje të numrit të fermerëve në dispozicion të hallkave të zinxhirit të vlerës në bujqësi.

Me përfundimin e stinës së dimrit, fermerët në të gjithë Shqipërinë duhet të ishin të angazhuar për sezonin e vjeljeve, tregtimit të prodhimeve të mbjella gjatë periudhës Mars-Maj dhe zbatimin në kohë të planifikimeve të mbjelljeve të reja, gjë që kërkon një nevojë në rritje të punësimit të punëtorëve sezonal, blerjen e materialeve që lidhen me paketimin dhe ambalazhimin e produkteve të prodhuara. Por masat për të frenuar në pandeminë COVID-19 krijuan një situatë jo të favorshme në aksesin e plotë të fuqisë punëtore, element ky që ka rezultuar në përmisim gjatë fashës së tretë (20 Prill 2020) dhe në vazhdim.

4.4. SEKTORËT E BUJQËSISË QË PARAQITEN NË FAZË PRODHIMI PËR TREG GJATË KËSAJ PERIUDHE PANDEMIE COVID-19

Në Shqipëri ka rreth 354.000 ferma bujqësore, ndërkohë që 172.000 prej tyre (49% e totalit) kanë një sipërfaqe më të madhe se 1 ha. Kjo është sipërfaqja minimale që mundëson ushtrimin e aktivitetit bujqësor gjysëm-komercial ose komercial (ne fushe te hapur) duke supozuar se e gjithë sipërfaqja përdoret për kulturat perimore. Gjithashtu nga përllogaritjet e PASH-it (Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve) rezulton se pragu komercial e kultivimit të perimeve në serra është 0.2 ha. Nga statistikat, në Shqipëri ekzistojnë rreth 1540 ha serra (nga të dhënat statistikore të pa-detajuara në qarqe janë 1650 ha, ndërsa nga vërtetimet në terren deri në Dhjetor 2019 sipërfaqja mund të jetë shtuar në rreth 1800 ha), ndërkohë që në studimet e donatorëve paraqitet një potencial për të përballuar rreth 5000 ha serra. Maqedonia një vend me një klimë jo shumë të përshtatshme dhe shumë larg me pozicionin dhe klimen në Shqipëri, ka të investuar rreth 3000 ha serra.

Prodhimi kombëtar		ooo/ton													
Vitet	Te tjera Bime Arrash	Shqipëria Prodh. 000/ton	QARQET												Vlore
			Berat	Diber	Durres	Elbasan	Fier	Gjirok.	Korce	Kukes	Lezhe	Shkoder	Tirane		
2012	Patate	233	5.3	27	9.4	30.5	35.6	8.1	60.5	11.6	9.2	20.4	12.1	3.2	
	Fasule	27.2	1.2	0.9	2.6	4.8	5.9	0.4	3.3	1	1.8	1.4	2.9	1.1	
	Perime	914	83.9	51.2	77.2	81.2	279.8	17.5	61.8	13.2	40	77	98.3	32.8	
	Fara vajore	2.4	0.1	0	0.1	0	2.3	0	0	0	0.4	0	0	0	
	Duhan	2	0	0	0.1	1.3	0	0	0	0	0	0.5	0	0	
	Foragjere	5950	362	574	495	690	1594	222	377	82	384	504	437	230	
2016	Patate	238.3	6.2	24.5	12.2	31.1	38.6	5.8	59.9	13.3	7.2	24.1	12.4	3	
	Fasule	24.8	1	0.8	2.2	4.2	5.7	0.4	3.1	0.7	1.5	1.2	3.1	0.9	
	Perime	1129.1	120.1	49.5	97.8	94	373.4	13.7	81.4	14.2	44.5	81.9	121.7	36.9	
	Fara vajore	2.6	0.3	0	0.1	0	1.9	0	0	0	0.3	0	0	0	
	Duhan	1.8	0	0	0	1	0	0	0.1	0	0	0.7	0	0	
	Foragjere	6144	368	480	591	800	1597	197	485	97	426	501	479	123	

Burimi: INSTAT, 2018

Sipërfaqja e mbjelle

000/ha

Vitet	Te tjera Bime Arrash	Shqiperia Sip. 000/ ha	QARQET												
			Berat	Diber	Durres	Elbasan	Fier	Gjirok.	Korce	Kukes	Lezhe	Shkoder	Tirane	Vlore	
2012	Patate	9.3	0.3	0.8	0.5	1.2	1.2	0.5	1.9	0.6	0.5	1	0.8	0.3	
	Fasule	14.6	0.6	0.4	1.4	1.8	3.6	0.3	2.4	0.2	0.9	0.9	1.7	0.5	
	Perime	31	1.6	1.6	2.5	2.5	6.3	1	2.7	0.6	1.8	4	4.8	1.5	
	Fara vajore	1.7	0	0	0	0	1.4	0	0	0	0.2	0	0	0	
	Duhan	1.3	0	0	0	0.8	0	0	0	0	0	0.4	0	0	
	Foragjere	208.9	13.6	23.7	18	21.6	45.6	12	15.1	5.7	14.4	16.4	18.7	4	
2016	Patate	9.7	0.4	0.8	0.5	1.3	1	0.4	2	0.6	0.5	1.1	0.8	0.3	
	Fasule	13.7	0.6	0.4	1.2	1.9	3.4	0.2	2	0.2	0.8	0.8	1.7	0.5	
	Perime	31.2	1.8	1.6	2.6	2.5	6.4	0.9	2.9	0.6	1.7	3.7	5	1.5	
	Fara vajore	1	0.1	0	0	0	0.7	0	0	0	0.1	0	0	0	
	Duhan	1.1	0	0	0	0.6	0	0	0.1	0	0	0.4	0	0	
	Foragjere	208.6	14.6	17.9	17.2	22.6	46.3	12	16.8	6.2	13.5	15.9	19.6	6	

Burimi: INSTAT, 2018

Sic shpjegohet në tabelën e mësipërme, kultivimi i perimeve (në serra dhe fushë të hapur) zë rreth 15% të sipërfaqes së tokës së punueshme. Qarku i Fierit zë sipërfaqe më të madhe në shkallë kombëtare me 6,300 ha, i ndjekur nga qarku i Tiranës me 4,800 ha.

Pothuajse 241,000 ferma, ose më shumë se 2/3 e totalit, prodhojnë perime; nga këto, rreth 5,708 janë të angazhuara në prodhimin në serrë, duke kontribuar me 8% të prodhimit total të perimeve.

4.4.1 Prodhimet e perimeve në serra.

Perimtaria është një nga sektorët më të rëndësishëm të bujqësisë dhe prodhimi i perimeve nga serrat, pa dyshim, është pjesa më dinamike e saj. Karakteristikat më thelbësore të perimtarisë shqiptare të viteve të fundit janë orientimi i qartë drejt prodhimeve për konsum të freskët, në vend të atij për përpunim industrial dhe akoma më shumë orientimi i qartë drejt eksporteve në tregjet rajonale dhe më gjerë.

Rrethi i Fierit është i njohur si rajoni tipik bujqësor, ku vitet e fundit sektorë të tillë si perimtaria dhe frutikultura kanë njohur rritje të vazhdueshme. Ndërkohë që renditet në vend të fundit mbi hapësirat dhe kapacitetet grumbulluese dhe ruajtuese, duke vështirësuar tregtimin e këtyre produkteve në tregun e shumicës dhe pikat e grumbullimit të Fierit, Lushnjës dhe Divjakës. Sipërfaqja me serra ka pasur një rritje të lartë, dhe vecanërisht serrat diellore. Në krahasim me vitin 2005 serrat diellore janë rritur me rreth 240%.

Vendi ynë ka potenciale të mëdha lidhur me eksportin e perimeve të freskëta, falë kushteve të favorshme klimaterike. Avantazhi kryesor krahasues me vendet e tjera të rajonit, si Maqedonia, Kosova, Serbia, etj., konsiston në hershmërinë e daljes në treg të perimeve me 1 deri në 2 muaj krahasuar me këto vende. Ky fakt është kuptuar më së miri nga fermerët shqiptarë të cilët përmes investimeve në mjedise të mbyllura (serra dhe tunele) arrijnë të dalin në treg me produkte perimore në një kohë kur nga vendet e Europës Qendrore dhe Lindore ka kërkesa për to. Kështu., psh, domatja, kastravec dhe speci në serra prodhohet duke filluar nga muaji mars, dhe deri në fund të prillit arrijnë cmime relativisht të larta.

Serrat	2005	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Serra ngrohje	35	57	68	40	49	55	70	71	55
me xham	11	16	14	14	14	14	15	19	23
me plasmas	24	41	54	26	35	41	55	52	32
Serra diellore	615	771	812	900	960	1,030	1,173	1,334	1485
me xham	81	80	78	69	64	60	46	47	42
me plasmas	534	691	734	831	896	970	1,127	1,287	1,443
Serra gjithsej	650	828	880	940	1,009	1,085	1,243	1,405	1,540

Burimi: INSTAT 2018

Investimet në serra janë të shtrira në rajonin e Shqipërisë së mesme dhe kryesisht në qarkun e Fierit, Beratit dhe një pjesë në qarkun e Elbasanit. Më poshtë paraqesim sipërfaqet me serra të ndarë sipas qarqeve në vend:

Siperfaqe e kultivuar ne serra kulture e I		Ha		
Nr /No	Qarku /Prefektura	2015	2016	2017
1	Berat	394	436	478
2	Diber	2	3	2
3	Durres	57	49	56
4	Elbasan	98	114	117
5	Fier	523	609	668
6	Gjirokaster	4	2	2
7	Korce	-	-	2
8	Kukes	1	1	1
9	Lezhe	7	8	10
10	Shkoder	75	99	115
11	Tirane	57	61	64
12	Vlore	26	24	26
Gjithsej / Total		1,244	1,406	1,540

Burimi: INSTAT 2018

Sic tregohet në tabelën e mëposhtme prodhimi i perimeve në serra ka një rritje të konsiderueshme në 5 vitet e fundit. Kjo si pasojë e rritjes së investimeve në serra dhe gjithashtu në një rritje të madhe të kërkesës së tregut të huaj. Aktualisht, investimet në serra janë biznesi më i qëndrueshëm dhe me kthyeshmëri të lartë, krahasuar me investimet e tjera në sektorët bujqësorë.

Prodhimi në serra në krahasim me vitin 2005 është rritur me 240%. Bazuar në statistikat e INSTAT serrat në Shqipëri arrijnë një prodhim total prej 244.468 ton, ku kryesisht dominon kultura e domates dhe kastravecit. Nisur nga të dhënat statistikore rezulton që prodhimi i perimeve në serra është përqëndruar në Qarqet e Fierit dhe Beratit, respektivisht 47.6% dhe 32.5% ku së bashku këto rajone mbulojnë më shumë se 79% të prodhimit të serrave në vend.


Për sa i përket vendeve të destinacionit të eksporteve të grupit të produkteve perimore, vlen për t'u theksuar se Shqipëria eksporton kryesisht drejt vendeve të rajonit: Serbi, Kosovë, Maqedoni, Mali të Zi, Bosnje – Hercegovinë dhe Bullgari.

Në këtë analizë tregu, do të marrim në shqyrtim disa prej këtyre vendeve. Në tabelën e mëposhtme jepen në menyrë të përmbledhur, sasitë e importuara të perimeve nga Shqipëria për vitin 2016. Në tabelë, vihet re qartë se për domaten shqiptare, vendet kryesore të eksportit janë Serbia, Kosova, Bullgaria dhe Bosnje – Hercegovina. Për sa i përket kastravecit, eksportet më të larta shkojnë në Serbi dhe Bullgari, ndërkohë që Kosova renditet e treta. Për specin, partnerët kryesorë janë Kosova dhe Mali i Zi.

Prodhimi vendas mbizotëron tregun e brendshëm, me përjashtim të muajve të dimrit (Janar-Shkurt) duke qënë se prodhimi në sera me ngrohje nuk i konkurren produktet e importit për disa arsye, përfshirë çmimin e lartë të lëndës djegëse që përdoret për ngrohje. Ndërkohë, prodhimi i serave diellore po shtohet dhe po bëhet gjithnjë e më konkurrues. Në përgjigje të këtij zhvillimi janë ngritur shumë kompani të fokusuar në grumbullimin dhe eksportin e fruta perimeve. Këto kompani ofrojnë infrastrukturën e nevojshme për grumbullimin, seleksionimin, standartizimin, paketimin dhe ruajtjen e këtyre produkteve.

Prodhimi i serrave sipas kulturave. Sic kemi shpjeguar edhe më lart 6 jane produktet kryesore që kultivohen në serra: domatja, trangulli, speci, patllixhani, kungulli dhe sallata. Nisur nga të dhënat statistikore, prodhimet e serrave përbëjnë volumet dhe të ardhurat kryesore të siguruar nga eksportet e grupit të perimeve.

Kryesisht 3 produktet kryesore të eksporteve janë: domatja, kastravecit dhe speci.



Domatja. Gjatë pesë viteve të fundit, prodhimi i domateve u rrit me 50% dhe importet u pakësuan gjatë 2010-2018. Në vitin 2018 eksportet shqiptare në kulturen e domates arriten nivelin e 69,999 ton, që është rreth 11 herë më i lartë se në vitin 2010, ose rreth 30% të prodhimit total për vitin 2018.

<i>Eksporti domates 2010 - 2018</i>				
Periudha	Orrigjina	Kodi i produktit ne databaze	Vlera e Tregtimit (US\$)	Pesha/volumi (kg)
2010	Albania	0702	\$1,939,372	6,573,354
2015	Albania	0702	\$22,251,572	57,547,058
2016	Albania	0702	\$26,428,563	63,700,856
2017	Albania	0702	\$33,981,858	70,333,572
2018	Albania	0702	\$37,814,660	69,999,896

Burimi: UNSTAT

Eksportet shqiptare eksportojnë rreth 27,5 kg domate për çdo kg të importuar me një bilanc tregtar pozitiv prej rreth 67,781 ton.

<i>Importi domates 2010 - 2018</i>				
Periudha	Orrigjina	Kodi i produktit ne databaze	Vlera e Tregtimit (US\$)	Pesha/volumi (kg)
2010	EU	0702	\$2,870,378	3,429,134
2015	EU	0702	\$1,856,367	3,055,263
2016	EU	0702	\$1,850,386	3,099,132
2017	EU	0702	\$1,693,981	2,552,775
2018	EU	0702	\$1,915,927	2,901,334

Burimi: UNSTAT

Rritja e prodhimit dhe eksportit pritet të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme, për shkak të investimeve në serra të mëdha moderne dhe rritjes së interesit të investitorëve të huaj. Duke pasur parasysh potencialin për zhvillim, prodhimi i domates (si pjesë e prodhimit të perimeve) është konsideruar si një sektor prioritar nga qeveria shqiptare për periudhën 2014-2020.

Domatja në Shqipëri prodhohet si një kulturë në fushë të hapur dhe në ambjente të mbrojtura. Ajo që vihet re në këto 3 vitet e fundit është rritja e sipërfaqes me serra nga ku kultivimi i domates zë me shumë se 55%. Prodhimi i domateve në fushe të hapur është më i lartë në Fier dhe Tiranë, por është i zakonshëm në të gjitha pjesët / rajonet e Shqipërisë, ndërkohë që prodhimi i domates së serrave është shumë i koncentruar në rajonet e Beratit dhe Fierit (përfshirë Lushnjën dhe Divjakën). Këto dy rajone së bashku përbëjnë rreth 83% të prodhimit të përgjithshëm të serrave dhe më shumë se gjysmën e prodhimit total të domates në Shqipëri. Qarku i Lushnjës është një nga zonat më produktive në Shqipërinë Qendrore.

Kastravec. Importet e kulturës së kastravecit mbeten të papërfillshme në krahasim me prodhimin; deficieti i vogël në tregtinë ndërkombëtare i regjistruar në vitet e kaluara është kthyer në një tepricë në tre vitet e fundit. Si përmbledhje, prodhimi i kastravecave dhe trendi i furnizimit ndoqën një model të ngjashëm me atë të domates.

Pothuajse 1/4 ose rreth 25% e sipërfaqes së përgjithshme të serrave janë të kultivuara me kastraveca, duke e renditur këtë kulturë të dytën pas domates; 71.7% e sipërfaqes së përgjithshme të serrave të prodhimit të kastravecave ndodhet në Qarkun e Fierit. Varietetet nën prodhim janë të përshtatshme për preferencat e konsumatorit shqiptar dhe atij për eksport, dhe në të njëjtën kohë varietete të vecantë janë bazë si lëndë e parë për fabrikat e konservimit (turshi).

Nga statistikat e UNSTAT-it vërehet një rritje e konsiderueshme e eksportit të kastravecit me një rritje rreth 14 herë krahasuar me vitin 2010. Eksporti i kastravecit zë vendin e dytë në volume dhe vlerë financiare në grupin e perimeve.

<i>Eksporti tragullit 2010 - 2018</i>				
Periudha	Orrigjina	Kodi i produktit ne databaze	Vlera e Tregtimit (US\$)	Pesha/volumi (kg)
2010	Albania	0707	\$343.340	1,481,104
2015	Albania	0707	\$4,077.123	10,482,984
2016	Albania	0707	\$6,796.376	14,761,246
2017	Albania	0707	\$9,644.026	21,020,958
2018	Albania	0707	\$10,237.165	17,058,942

Burimi: UNSTAT

Referuar të dhënave statistikore vërehet një ulje e importeve të kastravecit në sasira minimale, të cilat janë të pandjeshme në bilancin tregtar për këtë kulturë.

Eksportet e kastravecit kanë një rritje në 2013, ndërkohë që në 2014 paraqesin një rënie të lehtë. Në vijim ka një rritje të theksuar të eksporteve, mbi 10 mijë ton në 2015 dhe 21 mijë ton në vitin 2017 duke vazhduar në 2018 me 17,058,942, në një rënie të lehtë në volum por rritje në vlerë financiare.

<i>Importi tragullit 2010 - 2018</i>				
Periudha	Orrigjina	Kodi i produktit ne databaze	Vlera e Tregtimit (US\$)	Pesha/volumi (kg)
2010	EU	0707	\$1,001.292	1,077,361
2015	EU	0707	\$354.067	556,805
2016	EU	0707	\$282.230	441,913
2017	EU	0707	\$138.371	227,887
2018	EU	0707	\$209.828	291,076

Burimi: UNSTAT

Siperfaqja e mbjellë me kastravec në dy ciklet e prodhimit arrin në 924 ha, dhe qarqet kryesore në kultivimin e tij janë Lushnja, Berati, Elbasani.

Bullgaria është destinacioni kryesor i eksportit të trangujve shqiptarë me përafërsisht 1/3 e totalit të eksporteve. Një treg i rëndësishëm është edhe Maqedonia me rreth 22% të totalit të eksporteve, pasuar nga Serbia me 18.3% dhe Kosova 13.6%.

Speci. Kultura e specit është një nga tri produktet kryesore të bimëve të gjelbra në Shqipëri. Kërkesa është mjaft e lartë për të gjithë varietetet e prodhuara, nga ku mund të përmendim paprikën e kuqe është shumë më e kërkuar në Serbi, Maqedoni, Hungari dhe Rumani, ashtu edhe varietetin e zakonshëm "kapia" të prodhuara masivisht në Shqipëri.

Prodhimi i kulturës së specit në serra është mjaft fitimprurëse, si pjesë e një modeli prodhimi sezonal është gjithashtu pjesë e alternativës më efektive për rotacionin e bimëve, që përfshin domate, speca dhe sallata jeshile. Bilanci tregtar në këtë kulturë karakterizohet nga vetë-mjaftueshmëria e përgjithshme, si në rastin e domate dhe trangujve. Një zhvillim i rëndësishëm në lidhje me tregtinë ndërkombëtare të kesaj kulture shikohet në vitin 2014 ku eksportet tejkaluan importet. Aktualisht, eksportet janë rreth 10 here më të larta se importet.

<i>Eksporti specit 2010 - 2018</i>				
Periudha	Orrigjina	Kodi i produktit ne databaze	Vlera e Tregtimit (US\$)	Pesha/volumi (kg)
2010	Albania	70960	\$70,797	353,293
2015	Albania	70960	\$1,557,167	2,567,974
2016	Albania	70960	\$3,425,547	5,396,501
2017	Albania	70960	\$5,928,171	8,835,993
2018	Albania	70960	\$8,286,158	10,789,379

Burimi: UNSTAT

Per sa i përket importeve te specit, rminimizimi i sasisë së eksportuar është shumë e ndjeshme, nga 1612 ton importe në vitin 2010 ka një rënie prej 782 ton në vitin 2018.

<i>Importi specit 2010 - 2018</i>				
Periudha	Orrigjina	Kodi i produktit ne databaze	Vlera e Tregtimit (US\$)	Pesha/volumi (kg)
2010	EU	70960	\$1,528,269	1,612,912
2015	EU	70960	\$852,399	1,163,153
2016	EU	70960	\$701,320	952,773
2017	EU	70960	\$675,164	888,300
2018	EU	70960	\$629,270	782,907

Burimi: UNSTAT

Sa i përket eksporteve të specit, Mali i Zi ishte partneri më i rëndësishëm në vitin me afersisht 26.7% të totalit të eksportit të specave. Një tjetër partner i rëndësishëm eksportues për Shqipërinë është Serbia me 21.8% të totalit të eksporteve, pasuar nga Bullgaria (17.5%) dhe Kosova (13.3%). Vende të tjera ku Shqipëria eksporton specat përfshijnë: Greqinë, Kroacinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Maqedoninë, Republikën Çeke dhe Rumaninë.

Kultura e specit kultivohet masivisht në rrethet e Beratit, Lushnjës dhe Shkodrës.

Luleshtrydhja. Të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë tregojnë se në vitin 2016, sipërfaqja e mbjelle me luleshtrydhe ishte 91 hektarë. Ndërsa në vitin 2018, sipërfaqja e mbjellë është përqendruar në zonën e Fierit, duke arritur në 111 hektarë, me një rritje të lehtë prej 5.5%. Partnerët kryesorë tregtarë mbeten ata rajonalë, si Bosnjë e Hercegovina, Mali i Zi, Serbia dhe Maqedonia e Veriut. Ndërsa vitet e fundit janë shtuar edhe vende si Italia, Rumania, Bullgaria.

<i>Eksporti Luleshtrydhes 2014 - 2018</i>				
Periudha	Orrigjina	Kodi i produktit ne databaze	Vlera e Tregtimit (US\$)	Pesha/volumi (kg)
2015	Albania	81010	\$97,105	94,174
2016	Albania	81010	\$1,070,399	981,994
2017	Albania	81010	\$1,140,571	863,949
2018	Albania	81010	\$1,661,379	1,103,168

Burimi: UNSTAT

Tregu kryesor është ai lokal, kryesisht Tirana, por luleshtrydhet, sidomos të zonës së Fierit, eksportohen në volume të konsiderueshme jashtë vendit. Një treg i furnizuar gati 90% nga importi, deri në vitin 2010, është shndërruar që nga 2014 në potencial për eksport, krahas furnizimit të plotë të tregut vendas. Sipas shifrave të 2017 dhe 2018, eksportet e luleshtrydhes shqiptare janë 20-fishuar, në peshë dhe vlerë. Në vitin 2015, janë eksportuar 94 tonë luleshtrydhe, ndërsa në 2018 bëhej fjalë për 1.661 ton. Partnerët kryesorë tregtarë mbeten ata rajonalë, si Bosnjë dhe Hercegovina, Mali i Zi,

<i>Importi Luleshtrydhes 2014 - 2018</i>				
Periudha	Orrigjina	Kodi i produktit ne databaze	Vlera e Tregtimit (US\$)	Pesha/volumi (kg)
2015	Albania	81010	\$14,410	6,010
2016	Albania	81010	\$44,116	18,996
2017	Albania	81010	\$46,885	19,639
2018	Albania	81010	\$178,686	47,101

Burimi: UNSTAT

Vërehet që pavarësisht rritjes masivisht të eksporteve kemi një rritje në vitin 2018 edhe të importit të luleshtrydhes, pavarësisht së krahasur me eksportin është në raport 1:9. Kjo vjen si pasojë e mos-pasjes së tregut vendas të luleshtrydhes në sezone të ftohta (Dhjetor-Janar) që lidhet me prodhimtarinë e serrave me ngrohje qëndrore.

5. NDIKIMI I COVID-19 NË PRODUKTET PRANVERORE DHE AKSESI NË TREGJE.


Sic e kemi shprehur edhe më lart bujqësia në Shqipëri ka marrë një zhvillim të lartë në këto 10 vitet e fundit duke rezultuar me një rritje pothuajse 3-fish të eksporteve dhe një reduktim i ndjeshëm i importeve, dhe kryesisht të perimeve në serra dhe pemëve frutore.

Në këtë studim kemi marrë në vërtim 4 produktet kryesore të serrave që janë: Domatja, kastravec, speci dhe kungulli, dhe kulturën e luleshtrydhes që kultivohet në tunele plastike. Këto janë produktet e prodhuara nga fermerët gjatë periudhës pandemike në shqyrtim.

Bazuar në konvenirin bujqësor prodhimet e pritshme në këtë fazë shqyrtuese janë:

- Prodhimet e luleshtrydhes në muajin Mars rezultojnë në vjeljet e 3-4-5, duke qenë se 10-15% janë vjelë gjatë periudhës fund Dhjetori – Shkurt;
- Vjelja e kastravecit, kungullit, specit që fillon si produkti i parë i serrave në datën 15 Mars dhe vazhdon deri në javën e dytë të muajit Qershor
- Vjelja e domates që fillon në fundin e Muajit Mars dhe vazhdon deri në javën e dytë të muajit Qershor.

Më poshtë pasqyrojmë konvenirin bujqësor për perimet dhe frutat e periudhës Mars - Maj 2020.



Duke analizuar tabelën e mëposhtme vërehet një zhvillim i eksportit për produktet kryesore të kultivuara kryesisht në serra. Peshën më të madhe të eksportit e përmban produkti i domates, kastravecit dhe specit e ndjekur nga grupi i bostanorëve.

Më poshtë po pasqyrojmë të dhënat e eksporteve dhe importeve për vitin 2018 bazuar në të dhënat e FAOSTAT.

Nr	PRODUKTET	Prodhim 2018		Eksporti 2018		Importi 2018	
		Volume Kg	Volume (kg)	Vlera (USD)	Volume (kg)	Vlera (USD)	
1	Domate	90,750,000	69,999,896	37,814,660	2,901,334	1,915,927	
2	Kastravec	41,580,000	17,058,942	10,237,165	291,076	209,828	
3	Spec	10,395,000	10,789,379	8,286,158	782,907	629,270	
4	Kungull	5,775,000	1,408,014	880,788	47,548	31,860	
5	Patllixhan	3,465,000	5,068	4,080	323,481	242,353	
6	Luleshtrydhe	6,105,000	1,103,168	1,661,379	47,101	178,686	

Burimi: FAOSTAT

Importi i produkteve bujqësore perimore rezulton me një rënie të ndjeshme në 2-3 vitet e fundit, përafërsisht në vlerën rreth 5.3 milion euro, perkundrejt vlerës së eksportit që arrin në vlerën rreth 66 mil euro. Baza e produkteve tona të eksportit në grupin perimor janë produktet e serrave të cilat kryheson nga kultura e domates që mbulon në volum rreth 54% të prodhimit të përgjithshëm të eksportuar dhe rreth 57% në vlerë financiare të gjeneruar.

TE DHENA STATISTIKORE MBI PRODHIMTARINE DHE TE ARDHURAT PER PRODUKTET KRYESORE TE PERIUDHES 20 Mars-15 Maj 2020						
Nr	Produkti	Siperfaqja/ha	Prodhim total/Ton	Kosto Prodhimi/ALL	Te ardhura te pritshme nga shitja (nivel ferme)/ALL	Te ardhura te pritshme nga shitja (nivel grumbulluesi)/ALL
1	Domate I (55%)	907.5	90,750	2,487,276,000	6,071,175,000	6,806,250,000
	Trangull I (28%)	462	41,580	1,074,381,000	2,440,746,000	2,910,600,000
	Spec I (9%)	148.5	10,395	403,489,350	1,220,373,000	1,559,250,000
	Kungull I (5%)	82.5	5,775	177,882,375	375,375,000	693,000,000
	Patllixhan I (3%)	49.5	3,465	170,841,825	297,000,000	346,500,000
2	Luleshtrydhe	111	6,105	667,204,350	1,010,988,000	1,221,000,000

Domatja. Është produkti kryesor në peshën e eksporteve dhe paraqet një marzh fitimi të kënaqshëm për fermerët. Në Shqipëri fermerët prodhojnë disa lloje kultivuesh domate, gjë që krijon një mungesë planifikimi dhe unifikimi midis prodhimit dhe kërkesës së tregut të eksportit.

Referuar Kartës Teknologjike të prodhimit të domates (cikli I) rezulton që në një 1ha serrë e kultivuar me domate përfitohet një fitim neto rreth 1,510,450 leke. Ky është përfitimi i pritshëm mesatar për fermerët që kultivojnë domate pranverore me shfrytëzim serre në dy cikle prodhimi.

PERFITUESHMERIA NGA KULTIVIMI I DOMATES NE SERRA (cikeli 1) - Sipt. 1ha			
Totali shpenzimeve (lekë)	2,789,550	Kosto prodhimit (lekë/kg)	27,9
Te ardhura totale (lekë)	4,300,000	Çmimi mesatar i shitjes (lekë/kg)	43
Fitimi neto (lekë/ha)	1,510,450	Marzhi i fitimit	34,1%
Rendimenti në pikën kritike (kg/ha)	64,9	Produktiviteti i punës (kg/ditë pune)	138,9

Por, në përfitimin në serrë ndikojnë një sërë indikatorësh sic janë: cmimi tregut, efektet atmosferike, inputet bujqësore të përdorura etj. Në 2-3 vitet e fundit kemi pasur një luhatje të cmimit të tregtimit të domates, rezultuar me një rritje rreth 30-35% për cilësinë I, si pasojë e hyrjes së disa varieteteve të reja të kërkuara në tregun ndërkombëtar.

Gjatë periudhës 20 Mars – 20 Maj 2020 është vërtetuar zhvillimi i tregut të domates, duke siguruar informacion nga prodhues potencial dhe grumbulluesit/eksportuesit kryesor. Ky informacion është ndarë në fasha 10 ditore nisur nga fakti që cmimet e tregjeve lëvizin në varësi të prodhimit dhe kërkesës për produkt.

TE DHENA STATISTIKORE MBI PRODHIMTARINE DHE TE ARDHURAT PER PRODUKTET KRYESORE TE PERIUDHES 10 Mars-20 Qershor 2018-2019

Nr	Produkti	Sipërfaqja/ha	Prodhim total/Ton	Kosto Prodhimi/ALL	Te ardhura nga shitja (nivel ferme)/ALL	1 - 10 Prill		11 - 20 Prill		21 - 30 Prill		1 - 10 Maj		11 - 20 Maj		21 - 31 Maj		1 - 10 Qershor		11 - 20 Qershor	
						7%	100lek/kg	10%	90 lek/kg	20%	80 lek/kg	26%	70 lek/kg	14%	60 lek/kg	10%	40 lek/kg	8%	35 lek/kg	5%	30 lek/kg
1	Domate l	9075	90,750	2,487,276,000	6,071,175,000	635,250,000	816,750,000	1,452,000,000	1,651,650,000	762,300,000	363,000,000	254,100,000	136,125,000								

TE DHENA STATISTIKORE MBI PRODHIMTARINE DHE TE ARDHURAT PER PRODUKTET KRYESORE TE PERIUDHES 10 Mars-20 Qershor 2020

Nr	Produkti	Sipërfaqja/ha	Prodhim total/Ton	Kosto Prodhimi/ALL	Te ardhura te pritshme nga shitja (nivel ferme)/ALL	1 - 10 Prill		11 - 10 Prill		21 - 30 Prill		1 - 10 Maj		11 - 20 Maj		21 - 31 Maj		1 - 10 Qershor		11 - 20 Qershor	
						5%	100lek/kg	12%	100 lek/kg	20%	80 lek/kg	30%	60 lek/kg	16%	70 lek/kg	lek/kg	lek/kg	5%	lek/kg		
1	Domate l	9075	90,750	2,487,276,000	5,644,650,000	453,750,000	1,089,000,000	1,452,000,000	1,633,500,000	1,016,400,000											

Pra sic shikohet në tabelën e mësipërme në monitorimin e cmimeve në 5 fashat e para rezulton:

- Volumi i prodhimit të tregtuar është rritur gjatë vitit 2020 duke përfshirë në masën 83% të domates së prodhuar, në krahasim me volumin prej 77% në 2019.
- Të ardhurat e gjeneruara në vitin 2020 (për vetëm 83% të prodhimit të tregtuar) janë 5,644,650,000 lekë (45,891,463 euro), me një diferencë pozitive prej 326,700,000 lekë (2,656,098 euro) krahasuar me vitin 2019 ku janë arkëtuar rreth 5,317,950,000 lekë (43,235,365 euro).

Zakonisht, luhatjet janë të konsiderueshme në një treg global ku cmimet kanë fluktuacion të shpeshtë. Nderkohë situata Covid-19 në 10 ditëshin e parë të Prillit ka rezultuar me paqëndrueshmëri të tregjeve europiane dhe vecanërisht me kërkesë-ofertë, dhe kjo nuk mund të konsiderohet si një indikator negativ në tregtimin e domates së prodhuar nga fermerët e serrave për 10 ditëshin e parë të Prillit. E rëndësishme për tu theksuar është që kërkesa për eksport të domates në 2-3 fashat e fundit është rritur ndjeshëm si në volum ashtu edhe në cmim.

Kastravec. Është produkti kryesor i dyti në peshën e eksporteve dhe paraqet një marzh fitimi të kënaqshëm për fermerët. Në Shqipëri fermerët prodhojnë 3 lloje kultivarësh kastravec, ku kultivari i ri me (gjemba) i mbjellë këto 2 vitet e fundit ka rezultuar me përfshirje të ulët në tregjet e juaja. Planifikimi në fermë dhe orientimi drejt prodhimit dhe varieteteve të kërkuara ka sjellë një ndikacion negativ në të ardhurat e fermerëve të serrave.

Referuar Kartës Teknologjike të prodhimit të kastravecit (cikli I) rezulton që në një 1ha serrë e kultivuar me kastravec (kultivari persian) përfitohet një fitim neto rreth 1,423,450 lekë. Ky është përfitimi i pritshëm mesatar për fermerët që kultivojnë këtë lloj kastravec pranveror me shfrytëzim serre në dy cikle prodhimi.

PERFITUESHMERIA NGA KULTIVIMI I KASTRAVECIT NE SERRA (cikël 1) - Sipt. 1ha

Totali shpenzimeve (lekë)	2,526,550	Kosto prodhimit (lekë/kg)	28,1
Te ardhura totale (lekë)	3,950,000	Çmimi mesatar i shitjes (lekë/kg)	44
Fitimi neto (lekë/ha)	1,423,450	Marzhi i fitimit	36,0%
Rendimenti në pikën kritike (kg/ha)	57,6	Produktiviteti i punës (kgditë pune)	141,7

Sic kemi përmendur edhe më lart në këtë studim, gjatë periudhës 7 javore, e ndarë në 6 fasha kemi një vrotim të tregut në disa nivele, ku cmimet janë siguruar cdo ditë dhe është përcaktuar një cmim mesatar 10 ditor, nga ku rezultojnë të dhënat ekonomiko financiare për si më poshtë:

TE DHENA STATISTIKORE MBI PRODHIMTARINE DHE TE ARDHURAT PER PRODUKTET KRYESORE TE PERIUDES 10 Mars-20 Qershor 2018-2019

Nr	Produkti	Siperfaqja/ha	Prodhim total/Ton	Kosto Prodhimi/ALL	Te ardhura nga shitja (nivel ferme)/ALL	20 - 31 Mars		1 - 10 Prill		11 - 20 Prill		21 - 30 Prill		1 - 10 Maj		11 - 20 Maj		21 - 31 Maj		1 - 10 Qershor		11 - 20 Qershor	
						5%	100 lek/kg	12%	80 lek/kg	14%	70 lek/kg	20%	60 lek/kg	14%	50 lek/kg	13%	50 lek/kg	12%	40 lek/kg	8%	35 lek/kg	4%	30 lek/kg
1	Kastravec I	462	41,580	1,074,381,000	2,440,746,000	207,900,000	399,168,000	407,484,000	498,960,000	291,060,000	270,270,000	199,584,000	116,424,000	49,896,000									

TE DHENA STATISTIKORE MBI PRODHIMTARINE DHE TE ARDHURAT PER PRODUKTET KRYESORE TE PERIUDES 10 Mars-20 Qershor 2020

Nr	Produkti	Siperfaqja/ha	Prodhim total/Ton	Kosto Prodhimi/ALL	Te ardhura te prishme nga shitja (nivel ferme)/ALL	20 - 31 Mars		1 - 10 Prill		11 - 20 Prill		21 - 30 Prill		1 - 10 Maj		11 - 20 Maj		21 - 31 Maj		1 - 10 Qershor		11 - 20 Qershor	
						3%	30 lek/kg	12%	60 lek/kg	14%	50 lek/kg	22%	60 lek/kg	18%	50 lek/kg	15%	40 lek/kg	lek/kg	lek/kg	lek/kg			
1	Kastravec I	462	41,580	1,074,381,000	1,850,310,000	37,422,000	299,376,000	291,060,000	598,752,000	374,220,000	249,480,000												

Kultura e kastravecit në serra ka pasur një luhatje të cmimit në treg që kryesisht ka qënë i indikuar nga lloji i varietetit. Sic shikohet në tabelën e mësipërme nga monitorimi i cmimeve në 6 fashat që përfshijnë periudhën 20 Mars – 20 Maj 2020, dhe duke e krahasuar me të njëjtën periudhë/fashë me vitin 2019, kemi një diferencë të ndjeshme të cmimit dhe sasisë së prodhimit të tregtuar, për si më poshtë:

- Volumi i prodhimit të tregtuar është rritur gjatë vitit 2020 duke përthithur në masën 84% të kastravecit të prodhuar, në krahasim me volumin prej 78% në 2019.
- Të ardhurat e gjeneruara në vitin 2020 (për vetëm 84% të prodhimit të tregtuar) janë 1,850,310,000 leke (15,043,171 euro), me një diferencë negative prej 224,532,000 lekë (1,825,463 euro) krahasuar me vitin 2019 ku janë arkëtuar rreth 2,074,842,000 lekë (16,868,634 euro)

Nderkohë një problematikë në këtë periudhë rezultoi dalja në treg e një kultivari kastravec i (i shkurtër me gjemba) i cili nuk kishte cmim në tregun ndërkombëtar por edhe nga mos-respektimi i marrëdhënieve kontraktuale të pa-formalizuara fermer-eksportues.

Theksojmë, që kjo është ulje e vlerës financiare të gjeneruar nuk paraqitet si humbje e biznesit të fermerëve, ajo konsiderohet si **zvogëlim i fitimit të parashikuar të fermerit** dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të përlllogaritet si humbje në financimin e investimit të fermerit. Në të 6 fashat e monitoruara, fermieri ka tregtuar kastravec (të dy varietetet) mbi pikën kritike të koston së prodhimit (breakeven point), pra ka arritur të ketë një marzh fitimi brenda normales.

Speci. Është produkti i tretë në listën e produkteve bujqësore si në lidhje me eksportin ashtu edhe

me sipërfaqen e mbjellë në serra. Përfshihet në produktet që kërkon një shërbim agro-teknik të lartë gjë që ndikon në koston e prodhimit. Kosto e prodhimit nuk e kalon vlerën e 30 lekë/kg, por shpesh herë për mungesë intesiteti shërbimi agroteknik, kosto mund të arrijë vlerat deri në 50 lekë/kg. Prej kohës së daljes në prodhim, në të dy fashat kohore të analizuara ka rezultuar ekonomik për fermerët dhe eksportuesit. Në tregun European furnizuesi kryesor në këtë situatë pandemie ka qënë Maroku me një cmim mesatarisht 1.4 euro/kg.

Nga intervistat me eksportuesit, gjatë periudhës/fasha 1-10 Prill kërkesa për produktin spec ka qënë e lartë, dhe me një cmim më të lartë se një vit përpara.

PERFITUESHMERIA NGA KULTIVIMI I SPECIT NE SERRA (cikël 1) - Sipt. 1ha

Totali shpenzimeve (lekë)	2,789,550	Kosto prodhimit (lekë/kg)	28,1
Te ardhura totale (lekë)	3,950,000	Çmimi mesatar i shitjes (lekë/kg)	43
Fitimi neto (lekë/ha)	1,423,450	Marzhi i fitimit	35,1%
Rendimenti në pikën kritike (kg/ha)	57,6	Produktiviteti i punës (kgditë pune)	138,9

Referuar Kartës Teknologjike të prodhimit të specit (cikël I) rezultojnë që në një 1ha serrë e kultivuar me spec perfitohet një fitim neto rreth 1,423,450 lekë. Marzhi i fitimit të planifikuar është 35.1 % dhe kosto e prodhimit nëse respektohet intesiteti i shërbimeve agroteknike është 28.1 lekë/kg. Ky është perfitimi i pritshëm mesatar për fermerët që kultivojnë këtë lloj speci pranveror me shfrytëzim serrë në dy cikle prodhim. Kërkesa e tregut për kulturën e specit në serra ka rezultuar në rritje krahasuar me vitin 2019 dhe nga analiza e të dhënave gjatë 6 fashave të vrojtimit vërehet:

- Volumi i prodhimit të tregtuar është rritur gjatë vitit 2020 duke përfshirur në masën 93% të kulturës së specit të prodhuar, në krahasim me volumin prej 90% në 2019.
- Të ardhurat e gjeneruara në vitin 2020 (për vetëm 93% të prodhimit të tregtuar) janë 1,285,861,500 lekë (10,454,158 euro), me një diferencë pozitive prej 213,097,500 lekë (1,732,500 euro) krahasuar me vitin 2019 ku janë arkëtuar rreth 1,072,764,000 lekë (8,721,658 euro).

Kultura e specit vazhdon të ketë trend pozitiv dhe parashikohet që deri në fillim të muajit Qershor të kemi një rritje të të ardhurave në masën 15% krahasuar me vitin 2019.

TE DHENA STATISTIKORE MBI PRODHIMTARINE DHE TE ARDHURAT PER PRODUKTET KRYESORE TE PERIUDHES 10 Mars-10 Qershor 2018-2019

Nr	Produkti	Siperfaqja/ha	Prodhim total/Ton	Kosto Prodhimi/ALL	Te ardhura nga shitja (nivele ferme)/ALL	20 - 31 Mars		1 - 10 Prill		11 - 20 Prill		21 - 30 Prill		1 - 10 Maj		11 - 20 Maj		21 - 31 Maj		1 - 10 Qershor	
						7%	200 lek/kg	15%	160 lek/kg	26%	140 lek/kg	16%	120 lek/kg	14%	80 lek/kg	12%	70 lek/kg	6%	60 lek/kg	4%	40 lek/kg
1	Spec	148.5	10,395	403,489,350	1,220,373,000	145,530,000	249,480,000	378,378,000	199,584,000	99,792,000	72,765,000	49,896,000	24,948,000								

TE DHENA STATISTIKORE MBI PRODHIMTARINE DHE TE ARDHURAT PER PRODUKTET KRYESORE TE PERIUDHES 10 Mars-10 Qershor 2020

Nr	Produkti	Siperfaqja/ha	Prodhim total/Ton	Kosto Prodhimi/ALL	Te ardhura te pritshme nga shitja (nivele ferme)/ALL	20 - 31 Mars		1 - 10 Prill		11 - 20 Prill		21 - 30 Prill		1 - 10 Maj		11 - 20 Maj		21 - 31 Maj		1 - 10 Qershor	
						5%	200 lek/kg	15%	170 lek/kg	25%	140 lek/kg	20%	120 lek/kg	16%	90 lek/kg	12%	80 lek/kg	lek/kg	lek/kg		
1	Spec	148.5	10,395	403,489,350	1,285,861,500	103,950,000	300,415,500	363,825,000	249,480,000	168,399,000	99,792,000										

Kungulli. Rezulton produkti i katërt në grupin e perimeve të kultivuara në serra, me një përthithje më të vogël në krahasim me 3 produktet e tjera të lart-pemendura. Ka një bilanc shumë pozitiv tregtar, me një volum eksporti prej 10,789 ton dhe një vlerë financiare prej rreth 8.3 milion euro.

Por, gjatë kësaj sate pandemike vërehet një kërkesë e madhe e tregut të eksportëve për këtë produkt si në sasi ashtu edhe në cmim. Aktualisht volumi tregtar në të tre fashat kohore të analizuara pasqyrohet një rritje tregu rreth 289 ton dhe e reflektuar në një të ardhur të akumuluar prej 2,089,329 euro, dhe një rritje krahasuar me një vit përpara në një vlerë rreth 441,341 euro.

PERFITUESHMERIA NGA KULTIVIMI I KUNGULLIT NE SERRA (cikël 1) - Sipt. 1ha

Totali shpenzimeve (lekë)	2,789,550	Kosto prodhimit (lekë/kg)	27,9
Te ardhura totale (lekë)	4,300,000	Çmimi mesatar i shitjes (lekë/kg)	43
Fitimi neto (lekë/ha)	1,510,450	Marzhi i fitimit	35,1%
Rendimenti në pikën kritike (kg/ha)	64,9	Produktiviteti i punës (kg/ditë pune)	138,9

Referuar Kartës Teknologjike të prodhimit të kungullit (cikël I) rezulton që në një 1ha serrë e kultivuar me kungull përfitohet një fitim neto rreth 1,510,450 lekë. Marzhi i fitimit të planifikuar është 35,1 % dhe kosto e prodhimit nëse respektohet intesiteti i shërbimeve agroteknike është 27,9 lekë/kg. Ky është përfitimi i pritshëm mesatar për fermerët që kultivojnë kungullin me shfrytëzim serrë në dy cikle prodhimi.

Gjatë periudhës 10 Mars – 20 Maj 2020 është vrojtuar ecuria e aksesit në treg të kungullit, janë marrë informacione nga fermerët potencialë, informacion ky që është verifikuar edhe me pikat e grumbullimit të produkteve bujqësore.

Ne fakt kultivimi i kungullit ka pasur një përparësi apo përmirësim që lidhet me hyrjen në prodhim të disa kultivarëve të rinj (i gjelbri klasik) të kërkuara në tregun europian.

Kjo ecuri tregu në përthithjen e këtij produkti si në volum ashtu edhe në cmim vlen të analizohet nga ekstensionisti bujqësor (privat dhe shtetëror) për të përmisuar planifikimin në fermë bazuar në trendin e tregtimit të tij si në tregjet kombëtare dhe në vecanti ato të huaja.

TE DHENA STATISTIKORE MBI PRODHIMTARINE DHE TE ARDHURAT PER PRODUKTET KRYESORE TE PERIUDHES 10 Mars-20 Maj 2018-2019

Nr	Produkti	Siperfaqja/ha	Prodhim total/Ton	Kosto Prodhimi/ALL	Te ardhura nga shitja (nivel ferme)/ALL	10 - 20 Mars		21 - 31 Mars		1 - 10 Prill		11 - 20 Prill		21 - 30 Prill		1 - 10 Maj		11 - 20 Maj	
						5%	90 lek/kg	12%	80 lek/kg	30%	70 lek/kg	26%	60 lek/kg	16%	50 lek/kg	7%	40 lek/kg	4%	35 lek/kg
1	Kungull	825	5.775	177.882.375	375.375.000	25.987.500		55.440.000		121.275.000		90.090.000		46.200.000		16.170.000		20.212.500	

TE DHENA STATISTIKORE MBI PRODHIMTARINE DHE TE ARDHURAT PER PRODUKTET KRYESORE TE PERIUDHES 10 Mars-20 Maj 2020

Nr	Produkti	Siperfaqja/ha	Prodhim total/Ton	Kosto Prodhimi/ALL	Te ardhura te pritshme nga shitja (nivel ferme)/ALL	10 - 20 Mars		21 - 31 Mars		1 - 10 Prill		11 - 20 Prill		21 - 30 Prill		1 - 10 Maj		11 - 20 Maj	
						7%	100 lek/kg	15%	90 lek/kg	30%	80 lek/kg	28%	60 lek/kg	10%	50 lek/kg	7%	lek/kg	3%	40 lek/kg
1	Kungull	825	5.775	177.882.375	405.982.500	40.425.000		77.962.500		138.600.000		97.020.000		28.875.000		16.170.000		6.930.000	

Nga tabela e mësipërme vërehet një ecuri pozitive e prodhimit dhe tregtimit të kultures së specit, ku brenda 7 fashave të vrojtimit është tregtuar 100% prodhimi i fermerëve.

- Volumi i prodhimit të tregtuar është rritur gjatë vitit 2020 duke përthithur në masën 100% të kulturës së kungullit të prodhuar, në krahasim me vitin 2019.
- Të ardhurat e gjeneruara në vitin 2020 janë 405,982,500 lekë (3,300,671 euro), me një diferencë pozitive prej 30,607,499 lekë (248,841 euro) krahasuar me vitin 2019 ku janë arkëtuar rreth 375,375,000 lekë (3,051,829 euro).

Luleshtrydhja. Sic e kemi përshkruar edhe më lart, është një nga produktet që ka pasur një trend të mirë zhvillimi në këto 5 vite, pavarësisht se fermerët që e kultivojnë (zona Kafaraj) janë përballur me një sërë fatkeqësish natyrore në këto 2 vitet e fundit. Bazuar në statistikat e FAOSTAT-it (viti 2018), në Shqipëri kultivohen rreth 111ha luleshtrydhe, por nga konsultimet me fermerët dhe specialistët e bujqësisë, paraqitet një sipërfaqe rreth 200 ha të kultivuara me luleshtrydhe.

Fermerët kultivojnë dy lloj kultivaresh luleshtrydhe, Fortuna dhe Sabina, që kanë ndryshim me njëra tjetrën në ciklin prodhues, dmth shtrirje në kohë të prodhimit dhe vjeljes gjithashtu. Prandaj në këtë analize ne kemi konsideruar të dy llojet e kultivareve për arsye të aksesit të ndryshëm në treg. Cikli i prodhimit të Luleshtrydhes për të dyja varietetet është i njëjtë në prodhimtari, kosto prodhimi dhe cmim shitje. Tregtimi i produktit fillon nga muaji Dhjetor me sasi të vogla dhe përfundon në muajin Maj ose fillim të Qershor. Kulmi i prodhimtarisë së këtij fruti arrin në fund të muajit Prill dhe fillim të muajit Maj (sic është pasqyruar dhe në kartat teknologjike të kulturës). Nga analizat e zhvilluara të tregut rezultojnë se cmimi i një arke 5 kg (format i cili tregtohet luleshtrydhja në fillimin e prodhimit) varion nga 2,000 – 2,500 lekë/arka (Dhjetor), ndërsa në kulmin e sezonit ky cmim zbritet në 500 – 600 lekë/arka dhe në fund të prodhimit llogaritet me 200-300 lekë/arka (për përpunim).

PERFITUESHMERIA NGA KULTIVIMI I KUNGULLIT NE SERRA (cikël 1) - Sipt. 1ha			
Totali shpenzimeve (lekë)	6,010,850	Kosto prodhimit (lekë/kg)	109,3
Te ardhura totale (lekë)	9,150,000	Çmimi mesatar i shitjes (lekë/kg)	106
Fitimi neto (lekë/ha)	3,139,150	Marzhi i ftimit	34,3%
Rendimenti në pikën kritike (kg/ha)	36,131	Produktiviteti i punës (kgditë pune)	42,3

Totali i shpenzimeve për kultivimin e luleshtrydhes është relativisht i lartë, rreth 6,010,850 lekë/ha, me një të ardhur totale 9,150,000 lekë/ha, dhe një fitim neto 3,139,150 lekë/ha. Kosto e prodhimit për 1 kg luleshtrydhe është 106 lekë.

Situata e Covid-19 ka pasur një indikacion në tregtimin e luleshtrydhes dhe kryesisht gjatë periudhës 20 -31 Mars 2020, periudhë kjo lidhet me reflektimin e tregjeve ndërkombëtare ndaj produkteve të delikatesës (ose lluksit) dhe me qëndrueshmëri të ulët ndaj kontaminimit, një ulje të qarkullimit të mallrave, vendosjes së rregullave të karantinimit nga vendet e rajonit në mënyrë të c'organizuar (Mali e Zi, Kroacia etj.), mungesës së transportit ndërkombëtar dhe një drejtim të konusmatorit europian drejt produkteve të konservuara (me jetegjatësi skadencë). Tregtimi i luleshtrydhes bazuar në 2 llojet e kultivareve ka pasur këto indikacione:

- Kultivari i hershëm, Fortuna, duke qënë se akseson tregun nga muaji Dhjetor dhe ka një cikël prodhimi të gjatë, dhe cmimi në fashat e para, Dhjetor-Mars është relativisht i lartë, na rezulton me një performancë pozitive krahasuar me vitin 2019. Sic e kemi shpjeguar edhe më lart kultura e luleshtrydhes ka paraqitur një problem në 10 ditëshin e fundit të muajit Mars, ku tregu ndërkombëtar paraqiti një paqëndrueshmëri tregjesh. Megjithatë në këtë lloj kultivari nuk ka pasur ndonjë ndikim të lartë kjo situatë sepse paraqitet e recuperuar nga periudha para pandemike. Performanca financiare e këtij kultivari është më e lartë së viti 2019, duke gjeneruar një të ardhur totale prej 655,677,000 lekë (5,330,707 euro), pra një rritje krahasuar me vitin 2019 në vlerën financiare prej 149,572,500 lekë (1,216,036 euro). Ndërkohë vlera e gjeneruar gjatë vitit 2019 rezulton të jetë rreth 506,104,500 lekë (4,114,670 euro).
- Kultivari i vonshëm, Sabina, parashikohet të ketë një situatë me indikacion më të ulët në vlerë financiare krahasuar me varietetin Fortuna, për arsye të hyrjes në prodhim (15 Mars) në momentin e shfaqjes së Covid-19, gjë që ka ndikuar direkt në përthithjen nga tregu dhe cmimin gjithashtu. Ndërkohë që vërehet një përmirësim të ndjeshëm të situatës gjatë fashës së tretë 10 ditore të muajit Prillit edhe në vazhdim, ku përthithja nga tregu është më e lartë dhe cmimi ka një rritje të ndjeshme krahasuar me muajin Mars 2020, por jo duke u krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Me konkretisht gjatë 6 fashave të analizuara kemi një rritje të përthithjes së luleshtrydhes, dhe pavarësisht që kemi akoma 5% të produktit të patregtuar akoma, të ardhurat e gjeneruara rezultojnë me një pozitiv në vlerën e gjeneruar, përkatesisht 546,702,750 lekë (4,444,739 euro), me një rritje krahasuar me vitin 2019 në vlerën e 41,819,250 lekë (339,994 euro). Vlera e gjeneruar gjatë vitit 2019 është 504,863,500 lekë (4,104,744 euro).

Vlen të theksohet se vlera e planifikuar të gjenerohet për vitin 2020 do të rritet sepse kemi mbetet ende 5% e prodhimit e pa vjelur. Në përfundim të kesaj analize për kulturën e luleshtrydhes, për të dy varietetet, vërehet një përfitim financiar më i lartë krahasuar me vitin 2019.

Përmbledhje e rezultatit të vrojtimit

Sic është shpjeguar edhe më lart, nga analiza e produkteve të serrave të tregtuara deri në fashën e vrojtuar rezulton që prodhimi i serave është tregtuar me shtesë si në volume ashtu edhe në vlerë financiare, pra fermerët dhe konsoliduesit eksportues kanë gjeneruar një të ardhur më të madhe në krahasim me vitin 2019.

Me poshtë po paraqesim një tabelë të përmbledhur për cdo produkt serrë të analizuar.

PRODUKTET E SERRAVE				
Nr.	Produktet	Viti 2019	Viti 2020	Diferenca (ALL)
		Vlera e arketuar (ALL)	Vlera e arketuar (ALL)	
1	Domate	5,317,950,000	5,644,650,000	326,700,000
2	Kastravec	2,074,842,000	1,850,310,000	-224,532,000
3	Spec	1,072,764,000	1,285,861,500	213,097,500
4	Kungull	375,375,000	405,982,500	30,607,500
TOTALI (ALL)		8,840,931,000	9,186,804,000	345,873,000
TOTALI (EURO)		71,877,488	74,689,463	2,811,976

Vlen të theksohet që kjo diferencë pozitive pritet të rritet me vjeljen dhe tregtimin e një pjesë të prodhimit të vitit 2020, që i perket periudhës 20 Maj - 10 Qershor 2020.

Nderkohë që në kulturën e luleshtrydhes rezulton një rritje e ndjeshme krahasur me vitin 2019, pavarësisht se për varietetin Sabina ka akoma 5% produkt të pavjelur për treg.

PRODHIMI I LULESHTRYDYES NE TUNELE PLASTIKE						
Nr.	Produktet	Viti 2019		Viti 2020		Diferenca (ALL)
		Vlera e arketuar (ALL)		Vlera e arketuar (ALL)		
1	Luleshtrydhe	1,010,988,000		1,202,379,750		191,391,750
TOTALI (ALL)		1,010,988,000		1,202,379,750		191,391,750
TOTALI (EURO)		8,219,415		9,775,445		1,556,030

Pra si përfundim në total për 6 fashat e analizuara kemi një rritje vlere financiare të gjeneruar në shumën e 4,368,006 euro.

TE DHENA STATISTIKORE MBI PRODHIMTARINE DHE TE ARDHURAT PER PRODUKTET KRYESORE TE PERIUDHES 20 Mars-10 Maj 2018-2019

Nr	Produkti	Siperfaqja/ha	Prodhim total/Ton	Kosto Prodhimi/ALL	Te ardhura nga shitja (nivel ferme)/ALL	15 - 31 Dhjetor		Janar		Shkurt		Mars		1 - 10 Prill		11 - 20 Prill		21 - 30 Prill		1 - 10 Maj		11 - 20 Maj	
						2%	340 lek/kg	3%	400 lek/kg	3%	300 lek/kg	10%	250 lek/kg	17%	200 lek/kg	26%	150 lek/kg	23%	120 lek/kg	10%	60 lek/kg	6%	50 lek/kg
1	Luleshtrydhe (Fortuna)	55.5	3.053	333.602.175	506.104.500	31.135.500	36.630.000	27.472.500	76.312.500	103.785.000	119.047.500	84.249.000	18.315.000	9.157.500									

TE DHENA STATISTIKORE MBI PRODHIMTARINE DHE TE ARDHURAT PER PRODUKTET KRYESORE TE PERIUDHES 20 Mars-10 Maj 2020

Nr	Produkti	Siperfaqja/ha	Prodhim total/Ton	Kosto Prodhimi/ALL	Te ardhura te mateshme nga shitja (nivel ferme)/ALL	15 - 31 Dhjetor		Janar		Shkurt		Mars		1 - 10 Prill		11 - 20 Prill		21 - 30 Prill		1 - 10 Maj		11 - 20 Maj	
						2%	340 lek/kg	3%	400 lek/kg	3%	300 lek/kg	8%	180 lek/kg	18%	160 lek/kg	30%	200 lek/kg	22%	220 lek/kg	10%	240 lek/kg	4%	160 lek/kg
1	Luleshtrydhe (Fortuna)	55.5	3.053	333.602.175	655.677.000	31.135.500	36.630.000	27.472.500	43.956.000	87.912.000	207.570.000	147.741.000	73.260.000	19.536.000									

TE DHENA STATISTIKORE MBI PRODHIMTARINE DHE TE ARDHURAT PER PRODUKTET KRYESORE TE PERIUDHES 20 Mars-31 Maj 2018-2019

Nr	Produkti	Siperfaqja/ha	Prodhim total/Ton	Kosto Prodhimi/ALL	Te ardhura nga shitja (nivel ferme)/ALL	10 - 20 Mars		21 - 31 Mars		1 - 10 Prill		11 - 20 Prill		21 - 30 Prill		1 - 10 Maj		11 - 20 Maj		21 - 31 Maj	
						5%	280 lek/kg	10%	250 lek/kg	14%	200 lek/kg	18%	180 lek/kg	25%	160 lek/kg	16%	120 lek/kg	8%	60 lek/kg	4%	50 lek/kg
1	Luleshtrydhe (Sabina)	55.5	3.053	333.602.175	504.883.500	42.735.000	76.312.500	85.470.000	98.901.000	122.100.000	58.608.000	14.652.000	6.105.000								

TE DHENA STATISTIKORE MBI PRODHIMTARINE DHE TE ARDHURAT PER PRODUKTET KRYESORE TE PERIUDHES 20 Mars-31 Maj 2020

Nr	Produkti	Siperfaqja/ha	Prodhim total/Ton	Kosto Prodhimi/ALL	Te ardhura te mateshme nga shitja (nivel ferme)/ALL	10 - 20 Mars		21 - 31 Mars		1 - 10 Prill		11 - 20 Prill		21 - 30 Prill		1 - 10 Maj		11 - 20 Maj		21 - 31 Maj	
						5%	150 lek/kg	8%	90 lek/kg	16%	160 lek/kg	16%	200 lek/kg	26%	220 lek/kg	14%	240 lek/kg	10%	160 lek/kg	5%	lek/kg
1	Luleshtrydhe (Sabina)	55.5	3.053	333.602.175	546.702.750	22.893.750	21.978.000	78.144.000	97.680.000	174.603.000	102.564.000	48.840.000									

6. KONKLUZIONE

Gjetjet nga materialet e analizuara dhe anketimet e drejtpërdrejta me aktorë kyc ne zhvillimin e bujqësisë ofrojnë një tablo të qartë ku aktoret kryesore të zinxhirit vlerës financiare të indikuara nga Covid-19 ndahen në 3 grupime kryesore:

Financimi Bankar

Kërkesa për financimin e bujqësisë në Shqipëri është e lartë. Rëndësia e shërbimeve të kredisë rurale mund të kuptohet më mirë duke shqyrtuar kontributin e këtij sektori ndaj zhvillimit ekonomik të vendit. Bujqësia përbën një pjesë të rëndësishme të jetës së familjeve rurale, të cilët përbëjnë rreth 50% të popullsisë. Në nivelin makro, bujqësia përbën rreth 21% të PBB dhe vijon të dominojë ekonominë shqiptare për nga numri i të punësuarve me rreth 40% të totalit të të punësuarve. Ekziston një nevojë e madhe për kredi afatgjata për financim më të madh në makineritë bujqësore, qendra grumbullimi dhe trajtimi, serat dhe mbjelljen e pemishteve të reja, mbarështimit të blegtorisë si dhe në pajisje për përpunimin bujqësor. Gjithashtu edhe sektorët e qumështit dhe të hortikulturës ofrojnë mundësitë për financimin e zinxhirit të vlerës. Qasja në financa është shumë më e lehtë për përpunuesit dhe tregtarët me shumicë që shesin sasi të mëdha me një cikël më të shkurtër të projektit se sa për prodhuesit primar bujqësor.

Sektori i kreditimit të biznesit bujqësor në aktivitetet e përshkruara më lart, por jo vetëm, pritet të ketë një rritje të lehtë të NPL (Non Performed Loans). Kjo lidhet me mungesën e aftësisë paguese të fermerëve të vegjël që kultivojnë perime në serra (kryesisht kulturat që kanë ulje të ndjeshme të fitimit të planifikuar). Mundësitë e prodhuesve bujqësorë për burime financiare shtesë, gjatë periudhës së pandemisë, ballafaqohen me mjaft kufizime, të cilat japin efekte në prodhimin, në ristrukturimin e fermës dhe në investimet, që duhet të kryhen në to. Këto kufizime janë rezultat i kombinimit të faktorëve, që rrjedhin nga pengesa e aksesimit të nevojave për kredi si pasojë e qarkullimit, informacioni jo i plotë në tregjet financiare rurale si dhe i një sërë problemeve specifike të periudhës së pandemisë. Situata e Covid-19 në lidhje me levizjen e stafit të institucioneve financiare ka krijuar një distancim me klientët fermerë të kredituar. Kjo thellohet më shumë nisur nga pozicionet gjeografike të kredimarrëseve në zona rurale të cilët operojnë në distanca të largëta me pikat e shërbimit.

Mungesa ose ulja e kreditimit bujqësor gjatë kësaj periudhe dy mujore ka krijuar një pengesë në zhvillimet e disa nga aktivitetet bujqësore të cilat kanë nevojë për likuiditet. Kryesisht nevoja për kreditim lidhet me këto aktivitete:

- Mbjelljet e reja në fushë të hapur (drithërat dhe baza ushqimore për blegtorinë);
- Shërbimet agro-teknike në pemtari që lidhen me blerjet e inputeve bujqësore për spërkatje dhe plehrim;
- Kapital qarkullues për industrinë përpunuese (qumështit dhe konservimit) që lidhet me rritjen e kapaciteteve përpunuese si pasojë e rritjes së lëndës së parë të prodhuar nga fermerët;
- Kapital qarkullues për pikat e grumbullimit dhe eksportit dhe kryesisht atyre të eksporteve të perimeve në serra ku fluksi i lëvizjes së prodhimit është shumë i lartë;

- Pavarësisht se BE-ja lejoi shtyrjen e kontratave të projekteve fituese të IPARD-it, kreditimi i këtyre projekteve mbetet një pikë e rëndësishme në implementimin në kohë të planeve të investimit. Për më tepër, kjo lidhet edhe me përdorimin me efikasitet të fondit të garancisë së BERZH-it dhe Qeverisë Shqiptare.
- Vazhdimin e mbështetjes me kreditim të sektorëve potencialë, dhe kryesisht atyre që edhe në këtë situatë pandemike performuan shumë pozitivisht, sic janë ndërtimi i serrave bashkëkohore, sektorit të prodhimit dhe përpunimit të qumështit etj.
- Mbeshtetje të investimeve në sektorin bujqësor për ato teknologji që ndikojnë në mitigimin e riskut nga ndryshimet e kushteve atmosferike sic janë rrjetat antibreshër për të gjitha kategoritë e pemeve frutore, apo investimet që lidhen me sigurinë ushqimore dhe që tashmë janë detyrime të vendosura në rregullat bazë të menaxhimit të situatës post-pandemike sic janë standartet GMP, HACCP, ISO etj (kryesisht restorantet, turizmi në tërësi, bujtinat pritëse etj).

Agrobiznesi.

- Pavarësisht periudhës së vështirë në fillimin e pandemisë, prodhuesit e perimeve në serra dhe ato që kultivojnë luleshtrydhen kanë performuar pozitivisht financiarisht por edhe me aksesin në tregjet e eksportit.
- Situata e Covid-19 krijoi një paqartësi të përkohshme në grupe të ndryshme fermerësh dhe kryesisht atyre që kjo situatë i përkoji me daljen e prodhimit në treg. Aktivitetet më të ndjeshme të identifikuar janë: investimet në perimet e fushës (kryesisht kultivimi i patates), blegtorët e mbarështimit të imtave në rregjim kullusor dhe stallor, agroturizmi dhe turizmi rural etj. Problemi i furnizimit që tejkalon kërkesën e konsumatorit në njësinë e kohës, ndikoi në fermerët e vegjël të cilët nuk ishin në gjendje të shisnin prodhimet e tyre përmes daljeve të tyre normale dhe të preferuar për shkak të kufizimeve të vendosura nga bllokimi dhe masat e vendosura në lidhje me qarkullimin.
- Mungesa e orientimit të grupimit fermerëve të vegjël lidhet edhe më shlyerjen e kësteve dhe respektimin e aktit normativ të Bankës së Shqipërisë. Kjo vështirësi erdhi edhe si shkak i mos-qarkullimit të specialisteve të institucioneve financiare në terren.
- Shtyrja e investimeve të mbështetura me grantet e IPARD-it si pasojë e mungesës së respektimit të kontratave nga furnizuesit dhe kreditimit në kohë për pagesat e detyrimeve kontraktuale. Pandemia Botërore ka afektuar shumë sipërmarrje Europiane që prodhojnë teknologji bujqësore dhe pajisje për industrinë përpunuese. Mbyllja apo reduktimi i fabrikave prodhuese do të shoqërohet me vonesa në respektimin e kontratave me perfitesit e skemave të IPARD-it.
- Vështirësia e sigurimit të funksionimit të duhur të logjistikës siç është transporti për mallra dhe njerëz si dhe komplikime të tjera e vështiresoi më shumë problemin e paraqitur nga disponueshmëria e kufizuar e punëtorëve për sektorin bujqësor. Vlen të theksohet se në fazat e para problem i identifikuar ishte edhe transporti lokal apo ndërkombëtar për produktet e prodhuara nga fermerët.
- Mbyllja e restoranteve, shërbimeve të agro-turizmit apo turizmit rural dhe blerjet më pak të shpeshta ushqimore zvogëlojnë kërkesën për prodhime të freskëta dhe ato blegtorale,

duke prekur prodhuesit e vegjël dhe furnitorët lokal. Grupet me të prekshme përfshijnë fermerët në shkallë të vogël, të cilët mund të pengohen nga puna në respektimin e shërbimeve agro-teknike, hyrjen në tregjet e tyre për të shitur produktet e prodhuara ose për të blerë fara dhe inputet e tjera thelbësore. Në vecanti kjo do të ketë indikim për blegtorinë e imët, duke qënë se në këtë periudhë lindjet janë të mëdha dhe aksesit për tregtimin e qingjave dhe kecape është e vogël.

- Aktivitetet e turizmit rural (bujtinat pritese, agro-turizmi, turizmi i aventures etj.) paraqiten me të prekurit në këtë sektor, duke qënë se kjo është periudha ku ka frekuentim të lartë nga turistë të huaj por edhe ato lokal. Ndërkohë në këtë grupim vecojmë ato subjekte të cilët janë të kredituar nga sistemi bankar, dhe që masat post-pandemike do ta vështirësojnë gjenerimin e të ardhurave të planifikuara..
- Së fundmi sektori i peshkimit paraqet një humbje nga mungesa e tregjeve, kryesisht rezervatet e peshkut. Periudha 2 mujore e pandemisë shkaktoi një mungesë tregu për afërsisht 500 ton peshk rezervati, pra një vlerë financiare e pa gjeneruar për rreth 350,000,000 lekë (2,845,528 euro). Kjo shtoi koston e prodhimit për aku
- Akuakulturën si pasojë e vazhdimit të furnizimit me ushqim të rezervateve.